

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit


Dhjetor, 2025

Tiranë, më 19 Janar 2026: Ndryshimi vjetor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit¹ në muajin Dhjetor 2025 është +2,2 %. Rritja më e madhe e çmimeve prej 7,6 % vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë”, pasuar nga grupet “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 2,6 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 2,5 %, “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” me 2,3 %, “Shërbimi arsimor” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 2,2 % secili, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,1 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,4 %, “Shëndeti” me 1,1 %, “Veshje dhe këpucë” me 0,9 % dhe “Komunikimi” me 0,8 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 0,8 %.

Në muajin Dhjetor 2025, ndryshimi mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është +0,6 %. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,0 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,7 %, Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,5 % secili, “Veshje dhe këpucë”, “Argëtim dhe kulturë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,4 % secili dhe “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” me 0,2 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Komunikimi” u ulën me 0,1 %.


Rritja mesatare vjetore e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, në vitin 2025 është 2,3 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore dhe mujore të IHÇK




¹ Duke filluar nga indeksi i muajit Janar 2026, përlogaritja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit do të bëhet me klasifikimin e ri ECOICOP versioni 2.

Për publikim 19/01/2026

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor**Tab. 1 Ndryshimet në përqindje matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit**

Kodi	Grupet	Peshat	12-25/Viti-2024	12-25/12-20	12-25/12-24	12-25/11-25
	Gjithsej	1000	3,1	22,1	2,2	0,6
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	346,3	2,3	36,1	2,1	1,0
02	Pije alkoolike dhe duhan	51,6	4,8	18,3	2,5	0,7
03	Veshje dhe këpucë	37,1	2,9	13,5	0,9	0,4
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	56,0	1,9	10,0	1,4	0,5
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	56,9	3,9	18,7	2,3	0,2
06	Shëndeti	54,5	1,4	7,7	1,1	0,0
07	Transporti	78,5	-1,4	7,9	-0,8	0,0
08	Komunikimi	19,5	1,5	6,7	0,8	-0,1
09	Argëtim dhe kulturë	67,4	10,6	27,4	7,6	0,4
10	Shërbimi arsimor	47,1	3,4	11,7	2,2	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	149,0	4,2	17,0	2,2	0,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	36,1	3,3	11,9	2,6	0,5

Fig. 3 Ndryshimi vjetor i IHÇK sipas Shteteve, Dhjetor 2025²

² INSTAT publikon indekset e pa rumbullakosura, ndërsa EUROSTAT publikon indekset të rumbullakosura me dy shifra dhjetore. Kjo mund të shkaktojë ndryshime midis tyre, për shkak të metodës së ndryshme të rumbullakimit të përdorur nga secili institucion.

Metodologjia

Njoftim i rëndësishëm për përdoruesit

Duke filluar nga Shkurti 2026, me publikimin e indeksit të muajit Janar 2026, në përlogaritjen e indekseve të konsumit do të hyjnë në fuqi disa ndryshime metodologjike, si më poshtë:

- Indeksi i Çmimeve të Konsumit do të përlogaritet sipas Klasifikimit të ri Evropian të Konsumit Individual sipas Qëllimit, versioni 2 (ECOICOP 2);
- Periudha e referencës së indeksit do të përditësohet nga Dhjetor 2020=100 në Dhjetor 2025=100.

Ndryshime metodologjike

Nga muaji Janar 2017, INSTAT publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i llogaritur në bazë të:

1. Rregullores (BE) Nr 2016/792;
2. Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare
3. Programit të Statistikave Zyrtare, 2022-2026.

Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së Klasifikimit Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore. ECOICOP është klasifikimi i shpenzimeve i përdorur nga EUROSTAT.

Periudha referuese e çmimeve është muaji Dhjetor i vitit të mëparshëm, ndërsa periudha referuese e indeksit është muaji Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100).

Peshat për IHÇK janë llogaritur në përputhje me Nenin 3 të Rregullores Zbatuese (BE) 2020/1148. Peshat reflektojnë strukturën e Shpenzimeve Monetare të Konsumit Final të familjeve shqiptare dhe jo shqiptare në territorin e Shqipërisë.

Në muajin Janar të çdo viti IHÇK shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

IHÇK duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

- PËRKUFIZIME

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

- Ngjashmëritë midis IÇK dhe IHÇK

- *Qëllimi*

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- *Sistemi i klasifikimit*

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP)

- *Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve*

Përfshihen vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.

- *Të dhënat e çmimeve*

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njëjtat njësi tregtare, përdorin të njëjtin klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- *Periudha referuese (bazë) t*

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudha referuese muajin Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100)

- *Metodologjia*

IÇK dhe IHÇK ndjekin metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren e Komisionit Evropian (KE), Nr 2016/792, mbi IHÇK, për hartimin dhe grumbullimin e komponentëve të indekseve të çmimeve, e cila është zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së) në bashkëpunim me Institutet Statistike Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

- Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri
- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- *Mbulimi i produkteve*

- IÇK përmban 331 produkte
- IHÇK përmban 329 produkte

- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*
 - Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
 - IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.
- *Peshat*
 - Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
 - Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

Kodi	Grupet	Peshat	
		IÇK	IHÇK
	Gjithsej	100	1000
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,3	346,3
02	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	51,6
03	Veshje dhe këpucë	3,9	37,1
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,1	56,0
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	7,5	56,9
06	Shëndeti	3,5	54,5
07	Transporti	6,1	78,5
08	Komunikimi	3,0	19,5
09	Argëtim dhe kulturë	2,3	67,4
10	Shërbimi arsimor	3,4	47,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,7	149,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,6	36,1